



Pranuar / Dorezuar Prenje/Predata Received/Delivery	21. 12. 2020	viti god year
Organ / Qësia Organ /Jednica Org /Unit	SKPMŠHCK	
Br Prof Br Prof Prof No	3246/2020	
Shtojca Prilog Appendix		
Sasia Kolicina Quantity		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.354/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.354/2020 të datës 13.11.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED] me adresë rruga "Pjetër Bogdani", R13, Nr.48 në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 157 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.354/2020 e datës 13.11.2020 e parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, në bazë të autorizimit të datës 10.09.2019 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, me datë 14.09.2019 ka shpallur konkurs për rekrutimin e pozitës "Zyrtar për Shtetësi", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe kandidatja [REDACTED]

Me datë 11.09.2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Administratës Publike me datë 07.10.2019 ka njoftuar të gjitha institucionet publike për hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarë Publik dhe ka udhëzuar që të gjitha procedurat e konkurseve të cilat janë shpallur sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të pezullohen përkohësisht. Bazuar në këtë njoftim, Ministria e Punëve

të Brendshme me datë 08.10.2019 përmes shkresës Nr.782/19 të publikuar në ëbfaqe të Ministrisë ka njoftuar së është pezulluar procedura e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Shtetësi".

Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 25.11.2019 është pezulluar me vendimin Nr. ref.:VVMP 1525/20 për Masë të Përkohshme nga Gjykata Kushtetuese. Pas vendosjes se masës së përkohshme të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ministria e Administratës Publike me datë 10.01.2020 ka lëshuar njoftim me shkrim dhe ka udhëzuar të gjitha institucionet publike që ti aplikojnë dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil. Bazuar në këtë njoftim, Ministria e Punëve të Brendshme ka vazhduar procedurën e pezulluar për rekrutimin e pozitës "Zyrtar për Shtetësi" ku ka themeluar Komisionin Përzgjedhës, ka organizuar testin me shkrim, intervistën me gojë dhe në tërësi ka përfunduar procedurën e rekrutimit me datë 28.02.2020 përmes publikimit të njoftimit për kandidatin e suksesshëm [REDACTED].

Më datë 17.06.2020 U.d. e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka nxjerr Vendimin Nr.466 me të cilin ka anuluar konkursin e datës 14.09.2019, me arsyetimin se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike preken nga procesi i fuzionimit apo bashkimit sipas Vendimit nr. 07-v-005 të datë 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe me arsyetimin se procedura e listës se ngushte është bërë jashtë afatit prej 5 dite të përcaktuar me Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit.

Kandidatja e përzgjedhur [REDACTED] me datë 25.07.2020 ka parashtruar ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka shqyrtuar ankesën e ankueses.

Ankuesja, kundër heshtjes administrative të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 12.11.2020 nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmsheck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 13.11.2020 me Nr. Prot:2567/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.11.2020, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Kjo e fundit më datë 27.11.2020 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Më datë 02.12.2020 nëpërmjet e-mailit kemi kokrruar nga znj. [REDACTED], nëse ankuesja [REDACTED], kundër anulimit të konkursit ka parashtruar ankesë në KZKA, dhe përgjigje e saj më datë 03.12.2020 ka qenë që Divizioni i Burimeve Njerëzore i MPB-së, nuk ka qene i njoftuar se ankuesja [REDACTED] ka ushtruar ankesë në MPB.

Ankuesja më datë 18.12.2020 ka parashtruar kërkesën me numër protokolli 3193/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin thekson se e tërheq ankesën e datës 13.11.2020, me arsyetimin që KPMSHCK ka shfuqizuar Vendimin Nr. 466 të datës 17.06.2029, prandaj mbështetur në këtë do ti drejtohem MPB-së që të më lëshoj akt emërimin

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2567/2020 të datës 13.11.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e caktimit të punëdhënësit kryesor; Kontratë pune e ankueses e datës 05.09.2018; Kontrate pune për kohë të caktuar e datës 31.08.2017; Diplomë e datës 05.09.2005 e ankueses; Kontrate pune e datës 30.09.2019; Referencë nga ARBOTEK SH.P.K për ankuesen; Diplomë e datës 29.03.2017 e ankueses; Njoftimin e datës 28/02/2020 për kandidatin e suksesshëm; Form.MAP-SHCK-08 për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; për ankuesen; Raporti përmbledhës i datës 26.02.2020; Përmbledhja e vlerësimeve individuale datë 26.02.2020; Pyetjet e intervistës me gojë; Lista e aplikantëve për intervistë me gojë e datës 24.02.2020; Testin me shkrim të ankueses i datës 12.02.2020; Lista e ngushtë e aplikantëve për testin me shkrim datë 10.02.2020; Lista e aplikantëve që kanë hyr në testin me shkrim e datës 12.02.2020; Form.MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Vendimin me Nr. 466 i datës 17.06.2020 i u.d Sekretares së Përgjithshme të MPB për anulim të konkursit; Njoftimin për anulim të konkursit i datës 18.06.2020; Formularin Form.MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Vendimin me Nr. 81 i datës 05.02.2020 për themelimin të komisionit përzgjedhës të shërbimit civil; Autorizimi i datës 10.09.2019; Kërkesën për punësim të ankueses me dokumentet e bashkangjitura; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Regjistri i aplikacioneve të listës së ngushtë datë 10.02.2020; Lista e aplikantëve sipas pikëve të fituara nga testi me shkrim datë 18.02.2020; Kërkesën për prova shtesë e datës 02.12.2020 dhe përgjigjen e datës 03.12.2020; Kërkesën e datës 18.12.2020 nga ankuesja për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses ██████████, është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja, me datë 12.11.2020 nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 13.11.2020 me Nr. Prot:2567/2020, ndërsa më datë 18.12.2020 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 3193/2020 me të cilën ka deklaruar se tërhequr ankesën e datës 13.11.2020, me arsyetimin që KPMSHCK ka shfuqizuar Vendimin Nr. 466 të datës 17.06.2029, prandaj mbështetur në këtë do të drejtohem MPB-së që të më lëshoj akt emërimin. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", në këtë rast Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja me te drejte ka tërheq dorë nga ankesa, sepse vendimi me te cilin është anuluar procedura e përzgjedhjes së ankueses është shfuqizuar nga KPMSHCK me vendim të formës së prerë, prandaj MPB ka obligim që ankuesin ta ftoj për lëshim të akt emërimit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.354/2020; datë 21.12.2020

Avdyli BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses ██████████
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së